



## **FTESË PËR TENDER**

**Ref.: BBA 01/2023**

**Projekti : “Green skills for youth with hearing impairment”**

### **Termet e Referencës**

**Emri i Marrësit të Shërbimit :** Organizata Përtej Barrierave (Beyond Barriers Association-BBA)

**Ref. projektit:** “Green skills for youth with hearing impairment”

Organizata Përtej Barrierave, fton Tenderuesit e kualifikuar të paraqesin dokumentat për tender për procedurën e prokurimit “Green skills for youth with hearing impairment” (Ndërtimin e një sere për të rinjtë që nuk degjojnë), në kuadër të projektit “Green skills for youth with hearing impairment”.

Projekti mbështetet financiarisht nga Fondi i Ambasadës Kanadeze në Rome për Inicativat Lokale.

### **Mbi Projektin:**

Ky projekt propozim synon të ndërtojë një serë për rritjen e luleve dhe perimeve në ambientet e Institutit të nxenesve që nuk degjojnë, ku të gjithë nxënësit dhe studentët të kenë akses të plotë ditor. Ndërtimi i një sere dhe pajisja e studentëve me njohuri në kopshtari dhe hortikulturë është një hap vizionar për të siguruar një të ardhme dinjitoze për ata studentë që dëshirojnë të vazhdojnë më tej në këtë profesion. Ky projekt do të sjellë një perspektivë unike për nxenesit për pajisjen me kompetenca të reja në hortikulturë dhe kopshtari si dhe në procesin e shoqërizimit me të rinj të tjerë që do të dalin vullnetarë dhe do të japin kontributin e tyre vullnetar në serë.

### **Qëllimi i përgjithshëm I projektit:**

Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i 76 të rinjve nga “Institutit për nxënësit që nuk degjojnë” për të marrë aftësi në hortikulturë me një impakt të drejtpërdrejtë në fuqizimin e nxenesve për t'u bërë më të pavarur në të ardhmen duke hedhur hapat drejt një profesioni të ri. Ky projekt do të ofrojë një qasje të re inovative ndaj të mësuarit duke lidhur arsimin formal me metodologjitë joformale dhe duke i pajisur nxënësit e shkollave me aftësi punësimi dhe aftësi të tjera për jetën.



### **Target grupi:**

Përfituesit kryesorë të projektit të serës do të jenë 76 nxënës gjithsej, 33 vajza dhe 43 djem, nën 18 vjeç të cilët studiojnë tek “Instituti për nxënësit që nuk dëgjojnë” me vendndodhje në Tiranë, Shqipëri.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kompanisë:**

- Kompania duhet të kryejë një analizë të hollësishme të projektit dhe të përgatitë një plan të detajuar për ndërtimin e serës. Kjo përfshin hartimin e një plani të përshtatshëm për strukturën, hapësirat dhe pajisjet e serës.
- Sigurimi i materialeve dhe burimeve të ndërtimit: Kompania është përgjegjëse për identifikimin dhe sigurimin e materialeve të cilat janë të sigurta dhe të përshtatshme për nxënësit duke u kujdesur për sigurinë maksimale të nxënësve gjatë punës në sere.
- Ndërtimi i serës: Kompania duhet të kryejë punët e ndërtimit sipas planit të hartuar dhe miratuar nga stafi përgjegjës i organizatës Pertej Barrierave. Kjo përfshin ndërtimin e strukturave, instalimin e sistemeve të sigurisë që përmirësojnë përvojën e nxënësve në serë.
- Leja për ndërtim të serës: Kompania duhet të sigurojë lejen nga bashkia për konstruktin e serës në ambientet e Institutit. Instituti do të vendos në dispozicion dokumentat e nevojshme për këto leje dhe stafi i organizatës ben facilitimin e komunikimit midis kompanisë dhe Institutit.
- Koordinimi i projektit: Kompania është përgjegjëse për koordinimin e të gjitha aspekteve të projektit përveç ndërtimit të serës, duke përfshirë komunikimin me palët e interesuara, monitorimin e progresit të punëve dhe menaxhimin e ndonjë ndryshimi që mund të dalë gjatë procesit të ndërtimit.
- Kontrolli i cilësisë: Kompania duhet të sigurojë që punët e ndërtimit të realizohen me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet ligjore në Republikën e Shqipërisë si dhe specifikimin e planifikuar në planin e projektit. Ajo duhet të bëjë kontrollin e cilësisë dhe të sigurohet që sera të plotësojë kushtet e sigurisë dhe të përshtatet me nevojat e nxënësve që nuk dëgjojnë.
- Sera duhet të plotësojë të gjitha standardet e sigurisë dhe të jete një mjedis i rehatshëm pasi do të shërbejë si klase edukative për nxënësit. Sera duhet të ketë ventilimin përkatës dhe të jete në punë edhe në periudhën e verës.
- Afatet kohore dhe buxheti: Kompania duhet të përgatisë një plan afatshkurtër dhe afatgjatë të punëve që tregojnë kohën e nevojshme për të kryer të gjitha fazat e projektit. Në planin afatshkurtër, kompania duhet të përcaktojë fazat e ndryshme të ndërtimit dhe të caktojë afatet për secilën fazë, duke përfshirë kohën për hartimin e planit, sigurimin e materialeve, ndërtimin e strukturave dhe instalimin e pajisjeve të nevojshme. Këto afate duhet të jenë realiste dhe të përshtatshme me kompleksitetin e projektit dhe burimet e disponueshme. Në planin afatgjatë, kompania duhet të paraqesë një vizion të gjatë të projektit dhe të përcaktojë kohën e nevojshme për përfundimin e të gjitha punëve të ndërtimit dhe përshtatjen e serës për përdorim. Ky plan duhet të mbulojë aspektet si koordinimi i projektit, inspektimi i cilësisë,



provat dhe kontrolli final i punëve brenda afateve të rena dakort me stafin përgjegjës së organizatës Pertej Barrierave.

- Për sa i përket buxhetit, kompania duhet të përgatisë një ofertë financiare që përfshin kostot e nevojshme për materiale, punë, pajisje, dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me ndërtimin e serës. Buxheti duhet të jetë i detajuar dhe transparent, duke treguar çmimet e planifikuara për çdo pjesë të projektit dhe taksat e aplikueshme. Kompania gjithashtu duhet të sigurohet që buxheti i propozuar të jetë i përputhshëm me nivelin e kualitetit dhe standardet e kërkuara.
- Zbatimi i projektit të serrës pritet të ketë efekte pozitive në mjedisin natyror. Sera do të promovojë praktika të qëndrueshme bujqësore, të cilat mund të zvogëlojnë degradimin e tokës, përdorimin e ujit dhe ndotjen kimike të lidhur me bujqësinë tradicionale. Ai do të veprojë si një mjedis i kontrolluar, duke minimizuar nevojën për pesticide dhe duke rritur efikasitetin e përdorimit të ujit dhe lëndëve ushqyese.
- Sera, që do të ndërtohet duke përdorur një strukturë polikarbonate, do të ketë një ndikim pozitiv në mjedisin natyror. Polikarbonati, një material i sigurt (nuk thyhet) i qëndrueshëm dhe termikisht efikas, do të sigurojë që serra të mbajë një temperaturë të brendshme të qëndrueshme, duke reduktuar konsumin e energjisë për ngrohje ose ftohje. Ky material është gjithashtu i riciklueshëm, duke minimizuar ndikimin mjedisor në fund të jetëgjatësisë së tij.
- Sera duhet të ketë dysheme të shtruar me pllaka ose material të pershtatshëm me qëllim që nxenesit të mos behen pis kur punojnë pasi serra ka qelime edukative mesimore.
- Kuotimi juaj duhet të jetë i vlefshëm për një periudhë 45 (dyzetë e pesë) ditë nga afati i fundit për marrjen e kuotimeve.

## **SPECIFIKIME PER SEREN:**

### **Punimi i jashtëm:**

Sera do të ndërtohet në ambientin e jashtëm të “Institutit për nxënësit që nuk dëgjojnë” e cila ndodhet tek Rruga e Dibrës, Tiranë.

Sera do të jetë në përmasat 12m x12m (144M<sup>2</sup>)

Sera do të ketë një lartësi prej 4M

Materiali që do të duhet për veshjen e jashtme të serës duhet të jetë polikarbonat dhe me një strukturë të përbërë nga profile metalike, preferohet hekur.

### **Pajisje Elektrike:**

Pompa Furnizuese

Pompa Shpërndarjeje



Vetrata anësore me hapje anësore (preferohet mekanizem me hapje me telekomade)

Vetrata ne cati me mundesi hapje per ajrim (preferohet mekanizem me hapje me telekomade)

### **Sistemi Hidrant:**

Sera duhet te kete nje sistem hidrant tokësor, për vaditje dhe furnizim me ujë

Sera duhet te jete e shtruar me dysHEME pllakash/ose material te pershtatshem per process mesimor komfort

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

#### **Oferta teknike:**

- a) Shprehjen e interesit per te marre pjese ne tender te nënshkruar nga ofertuesi.
- b) Një formular të plotësuar identifikimin financiar, për të treguar llogarinë bankare në të cilën duhet të bëhen pagesat nëse tenderi është i suksesshëm.
- c) Kopje te ekstraktit historik, QKB
- d) Fotokopje e NIPT-it
- e) Prezantim i kompanisë dhe punës së saj
- f) Adresen zyrtare, person pergjigjes dhe kontaktet e plota.

Ofertuesve u kujtohet se dhënia e informacionit të rremë në këtë procedurë tenderimi mund të çojë në refuzimin e ofertës së tyre dhe në përjashtimin e tyre nga procedurat e tenderimit.

#### **Oferta financiare**

Oferta financiare përbëhet nga dokumentet e renditura më poshtë

- a) Vërtetim për statusin aktiv të kompanisë.
- b) Dokumentin e plotësuar te bashkengjitur te ofertes financiare
- c) Pasqyra Financiare per periudhat 2021 dhe 2022.
- d) Draft projekti teknik dhe konstruktiv i serës (Plan 3D I serës)

#### **Procedura e aplikimit:**

Subjektet e interesuara duhet të dërgojnë dokumentat e siperpermendura brenda datës 5 Shtator 2023 në kopje fizike ne zyrat e organizates Pertej Barrierave ne adresen:

**Shoqata Pertej Barrierave,  
Adresa: Rr. Don Bosko, Pall Gener 2, Kati 6, Ap 47, Tirana, Albania**



Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, të shënuar Emrin e Subjektit tuaj dhe si me poshte:

**Ref.: BBA 01/2023**

**Projekti : “Green skills for youth with hearing impairment”**

Informacione apo pyetje të mëtejshme mbi aplikimin mund të merren nga Organizata Përtej Barrierave deri në datën 25 Gusht 2023, ora 16:00 me email tek [office@beyondbarriers.org](mailto:office@beyondbarriers.org)

**Shënim:** Aplikimet e ardhura pas afatit të vendosur në ToR dhe ato të cilat nuk janë të plota nuk do të merren në konsideratë.

### **Perzgjedhja e fituesit të tenderit**

Komisioni i vleresimit të tenderimit i përbërë prej 3 personash, do të mbledhet në dt. 07.09.2023, ora 09:00 dhe ju do të njoftoheni për rezultatin e vleresimit brenda datës 08.09.2023, përmes e-mailit, me njoftim zyrtar.

### **Kriteret e perzgjedhjes**

Perzgjedhja e fituesit të tenderit do të bëhet bazuar mbi këto kritere, të vlerësuara në pike:

- Oferta teknike – 40 pike
- Oferta financiare – 60 pike

Permbushja e kushteve teknike është domosdoshmeri. Ofruesi duhet të marrë minimum 20 pike tek oferta teknike.